



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura e –III-

**KOMISIONI PARLAMENTAR PËR BUJQËSI, PYLLTARI,
ZHVILLIM RURAL, MJEDIS DHE PLANIFIKIM
HAPËSINOR**

Procesverbal Nr. 7
nga mbledhja e mbajtur më **10.4.2008**
kryesuar nga **Lulzim Zeneli**-kryetar i komisionit
Mbledhja filloi në orën 11,00

Të pranishëm :

Lulzim Zeneli kryetar i Komisionit, Ibrahim Selmanaj, Berat Luzha, Zef Morina , Hesel Cakolli , Myrvete Pantina, Ali Lajçi, Kosara Nikolić, Elheme Hetemi dhe Zylfi Merxha

Mungoi :

Selvie Halimi

Nga Sekretaria e Kuvendit : Bajram Badivuku dhe Lule Ymeri.

Pjesëmarrësit tjerë : Muhamet Aliu, Tirana Baftiu, Jashar Kastrati, si
dhe vëzhguesi nga presidenca-Nexhat Shatri

RENDI I DITËS U MIRATUA PA VËREJTJE :

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Projektligji për Shitjen e Banesave në të cilat ekziston e drejta banesore,
3. Të ndryshme

1.Procesverbali nga mbledhja e kaluar u miratua .

2.Projektligji për Shitjen e Banesave në të cilat ekziston e drejta banesore

Kryetari Lulzim Zeneli para se të vazhdoi nga amendamenti ku ka mbetur komisioni në mbledhjen e kaluar, kërkoi qëndrimin e MMPH lidhur me propozimin e deputetit Gani Koci për Nenin 1.

Muhamet Aliu tha se ky propozim kërkon analizë, mirëpo qëndrimi në MMPH është se ky propozim mund të rregullohet vetëm me ligj të veçantë , çka edhe do të bëjë Ministria. Përndryshe edhe po të hyjë ky propozim në këtë ligj, nuk do të bëjë punë. **Berat Luzha** pyeti për mundësinë e rregullimit me akt nënligjor, por përgjigja ishte negative nga sekretari i MMPH, ngase definicioni për bartësin e drejtës banesore është bazike për MMPH.

Ali Lajçi tha se e kupton këtë qëndrim të MMPH por pyeti : çka nëse na del detyrimi për të pritur disa ligje të veçanta e jo vetëm një?

Myrvete Pantina u pajtua që kjo problematikë e banesave të ndërhuara-përfunduara pas luftës, të rregullohet me ligj të veçantë.

Berat Luzha ishte i mendimit se do të shkaktohet zvarritje e panevojshme nëse nuk hyn propozimi në fjalë në këtë ligj, për shkak se njerëzit janë brenda nëpër banesa dhe kanë fituar drejtën banesore. **Tirana Baftiu** reagoi dhe tha se ata që janë brenda nëpër banesa kanë vetëm drejtën e shfrytëzimit.

Ibrahim Selmanaj e kundërshtoi propozimin e Gani Kocit ngase do lindin kundërshtime me vet ligjin në fjalë.

Elheme Hetemi tha se MMPH mundet me thënë qëndrimin , por deputetët janë ata të cilët mund dhe duhet të mbledhin informata.

Lulzim Zeneli rikujtoi anëtarët e komisionit se ky projekt duhet të shkojë tutje me procedurën parlamentare, ndaj një zgjidhje duhet të gjendet.

Tirana Baftiu sqaroi se në bazë të këtij ligji, banesën do ta blejë vetëm ai që ka dokumentet në rregull.

Zef Morina ishte decidiv kundër propozimit të Gani Kocit, ngase një aline e tillë do të krijoj probleme tjera. **Berat Luzha** tha se problem paraqet vetëm periudha kohore-pas lufte. Reagoi përfaqësuesi i MMPH se ky ligj nuk trajton periudhën kohore, por vlen për të gjithë. **Muhamet Aliu** theksoi se drejta e pronësisë duhet të ketë bazën , përndryshe nëse ka laramani në këtë drejtim, krijohen probleme të rënda.

Lulzim Zeneli pasi që konstatoi papajftueshmërinë e disa anëtarëve të komisionit, ftoi komisionin për votim, dhe nxori këtë :

PËRFFUNDIM

Pasi që votimi ishte barazi (3 për dhe 3 kundër me dy abstenime), **komisioni nuk japi mbështetje propozimit të Deputetit GANI KOCI** për të shtuar një paragraf Nenit 1 lidhur me banesat të përfunduara pas luftës, të cilat kanë filluar të ndërtohen para luftës, për shkak se vota e kryetarit konsiderohet dyfish , në rastet kur janë votat e barabarta.

Amendamenti 10

Neni 13 riformulohet :

Banesa për të cilën është vërtetuar se pronari i saj është i panjohur, e shetë komuna në territorin e së cilës ndodhet banesa.

Amendamenti 11

Neni 14.1 riformulohet :

(1) Në kuptim të këtij ligji, banesat me pronarë të panjohur konsiderohen ato banesa në lidhje me të cilat bartësi i së drejtës që ka në disponim është personi juridik i cili nuk e ka regjistruar veprimtarinë tij , ose ka ndërprerë aktivitetet e tij dhe suksesori i të cilit është i pa njohur ose i pa definuar ose selia e të cilit nuk dihet dhe që, bartësi i të drejtës banesore nuk është në gjendje të bëjë kërkesë për blerjen e banesës brenda afatit të paraparë me nenin 7 paragrafin 2 të këtij Ligji.

Amendamenti 12

Neni 15, fshihen paragrafet 3,6 dhe 7, ndërsa nuk mbështetet propozimi i Gani Kocit për paragrafin 7.

Amendamenti 13

Neni 16, tri paragrafet e para riformulohen si vijon :

- 1) Ministria vërteton se cilat banesa bëjnë pjesë në institucionet bamirëse, , sipas nenit 15 pika 4 të këtij Ligji.**
- (2) Qeveria përcakton se cilat banesa bëjnë pjesë në ndërtesat administrative ose reprezentative, sipas Nenit 15 pika 2 të këtij Ligji.**
- (3) Komuna vërteton se cilat banesa janë ngritë ose blerë nga mjetet e dhëna ose të mbledhura për qëllime bamirësie ose qëllime tjera me interes shoqëror, sipas Nenit 15 pika 4 të këtij Ligji.**

Paragrafet 5 dhe 6 të Nenit 16 fshihen.

Amendamenti 14

Neni 18, paragrafi 2 riformulohet :

(2) Gjatë lidhjes së kontratës palët duhet të respektojnë afatin e përcaktuar me nenin 7 të këtij Ligji. Kontrata e nënshkruar nga palët kontraktuese vërtetohet në gjykatën kompetente.

Në vazhdim komisioni diskutoi rreth neneve 20-25 të cilat përcaktojnë vlerën e banesës dhe kishte disa mendime : 300 euro është tepër shumë e lartë etj. Më tutje (**Nexhat Shatri dhe Kosara Nikoliq**) u tha se këto banesa për të cilat bënë fjalë ligji, nuk janë sikurse banesat e tregut për shitje, ndaj baza nuk është kryesore për këto banesa, gjithashtu disa janë të vjetëruara, amortizuara, disa pa ngrohje etj. **Myrvete Pantina** dhe disa anëtarë tjerë kërkuan nga MMPH të jap sqarim se si kanë ardhë deri te këto analiza dhe përfundim për çmimin 300 euro . Komisioni përfundoi debatin dhe **kërko**i nga MMPH që deri në mbledhjen e radhës të sjellë qëndrimin, përkatësisht mendimin për vlerën e banesës duke mos kaluar shumë 100 euro.

Amendamenti 15

Neni 36

Nga shuma e tërësishme e mjeteve të realizuara, me shitjen e banesave, **30%** e tyre derdhën në Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës në llogari të veçantë për banim dhe **70 %** të mjeteve i mbanë komuna. Këto mjete shfrytëzohen enkas për:

Amendamenti 16

Fshihet kreu VII.

Amendament 17

Fshihet Neni 40.

Amendamenti 18

Fshihet paragrafi 3 i Nenit 41.

Amendamenti 19

Fshihet neni 42.

Amendamenti 20

Neni 43, riformulohet :

Kontratat mbi shfrytëzimin e banesës të cilat janë arritur në pajtim me dispozitat e Ligjit mbi Marrëdhëniet Banesore (“Gazeta Zyrtare e KSAK”-së, Nr. 11/83, 29/86 dhe 42/86), që formalisht janë lidhur deri në ditën e zbatimit të këtij Ligji, do të jenë të vlefshme më së voni deri në dy vite pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Amendamenti 21

Neni 46, riformulohet :

Ministria me udhëzim administrativ të paraparë me nenin 24.2 të këtij ligji, do ta nxjerr në afat prej 12 muajsh prej ditës së hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Mbledhja e komisionit përfundoi në orën 12,50

Bajram Badivuku
Admin. i Komisionit,

Kryetari i Komisionit,
Lulzim Zeneli